

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 9 QERSHOR 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Kolegë deputetë,

Pse duhet garancia sovrane, tha kolegu im i opozitës, kur kompanitë janë të shëndosha. Po mirë, pse duhej garancia e parë sovrane, garancia e dytë sovrane, të cilat gjatë periudhës së pandemisë ishin aty për të gjitha kompanitë e shëndosha, të cilat kishin nevojë për të aksesuar likuiditetin e nevojshëm për pagat e punonjësve, që të mos krijohesh një rrjedhje dhe më masive, pavarësisht se e rikuperueshme, përgjatë vitit 2020, por për të vijuar më pas me mbështetjen me likuiditet, për aktive fikse apo për kapital qarkullues?

Ndërsa sot, sikurse në aktin normativ që e keni përpara, mund ta lexoni shumë konkretisht, ne nuk po flasim për një situatë normale, por flasim në vijim të aktit normativ nr.7, si një detyrim për të krijuar një rezervë 3- mujore për subjekte që furnizojnë ose kanë përgjegjësinë e furnizimit me disa produkte ushqimore bazë, për arsye të përgjegjshmërisë që kjo qeveri ka treguar në momente krize, por jo vetëm, po të paktën në momente krize, si me garancinë e parë apo të dytë shtetërore gjatë pandemisë, edhe në këtë situatë, po vjen për të mbështetur këto kompani, qofshin 3, 4, 5 nuk ka rëndësi, për të aksesuar likuiditet, si dhe për të siguruar këtë rezervë 3-mujore. Kjo gjë është e lexueshme, sepse e kemi diskutuar edhe në komision, por edhe secili nga deputetët e ka përpara.

Pra, nuk ka ndonjë situatë të jashtëzakonshme, por unë besoj se për të herë të parë, për mbështetje të biznesit, jo vetëm sot, por gjatë gjithë mbështetjeve për garanci shtetërore, ne të mos kishim xhakete politike, po të kishim një xhakete në mbështetje të biznesit, dhe si parlamentarë ta votonim të gjithë këtë akt normativ. Tani, dua të them dy fjalë për sa u takon garancive shtetërore. Sikurse e diskutuam edhe në Komisionin e Ekonomisë, absolutisht ne po flasim për garanci shtetërore, të cilat qeveria i sjell jo vetëm në formën e aktit normativ, pasi

kjo është një situatë e vështirë dhe kërkon një reagim të menjëhershëm me akte normative, për të mbështetur vendime të qeverisë, por mbi të gjitha ne duhet të kalojmë në një tejkalim të situatave momentale të krizave, që sjell secila situatë, aktualisht lufta Rusi - Ukrainë, për të kaluar në mbështetje të biznesit në një mënyrë të qëndrueshme.

Kemi pasur edhe më parë mbështetje të biznesit, sidomos në sektorin e bujqësisë dhe turizmit. Dua të përmend këtu garancinë, e cila në një formë ndryshe i ka ardhur sektorit të bujqësisë prej vitit 2016, me mbështetjen që qeveria shqiptare ka dhënë nëpërmjet fondeve të garancisë së bashku me BERZH-in, ashtu edhe me KfW-në, garanci e cila nuk ka pasur të gjithë efektivitetin dhe publicitetin e mundshëm. Megjithatë, dua të them se në Komisionin e Ekonomisë kemi diskutuar që garancinë shtetërore duhet të vijë drejt një platforme dhe një strategjie afatmesme, në mënyrë që të gjitha bizneset në këta sektorë të rëndësishëm të përfitojnë maksimalisht. Çfarë përfitohet nga biznesi në këtë akses finance?

Për sa kohë hyn shteti garant në aksesin për likuiditet për ato që janë kompani të shëndosha, nëpërmjet sektorit bankar, garantohet likuiditet, interesa më të ulta dhe mungesë burokracie, kur vjen çështja për kërkesën e kolateralit. Për ndihmën ndaj bizneseve të vogla dhe të mesme, por jo vetëm në sektorët e bujqësisë, të turizmit, në platformën e qeverisë "Rama 3" kemi folur për ndihmën drejt të gjithë automatizimit dhe dixhitalizimit për ta sjellë ekonominë shqiptare drejt asaj cilësie dhe shkalle që është nevojshme për të konkurruar në rajon, dhe që është e nevojshme që aksesin në financë të silltet si një vëmendje strategjike afatmesme.

Në këtë kuptim, është shumë e domosdoshme që si monitorimi, ashtu edhe përgatitja e kësaj strategjie, të vijë e kompletuar dhe të mbikqyret për efektivitetin e gjitha këtyre masave në një institucion të veçantë, duke shpresuar, ashtu sikurse e tha dhe ministrja, që ndryshimi ligjor, i cili është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për këtë produkt, të vijë brenda vitit. Ne sot miratojmë një garanci shumë të vogël për atë që është e nevojshme për biznesin në Shqipëri dhe prandaj e kthejmë vëmendjen drejt asaj që është strategjia afatmesme për garancitë, por në qoftë se flisni me bizneset, të cilat kanë nevojë për likuiditet dhe ballafaqohen me bankat e nivelit të dytë, përtej historisë shumë të mirë të zhvillimit të këtyre marrëdhënieve, ka ende

burokraci, ka ende situata ku garancia vjen më e kërkuar sesa vetë biznesi mund të ofrojë, ka diskutime për normën e interesit.

Prandaj, të diskutosh dhe të kritikosh përsëri qeverinë se ofron garanci sovrane për biznesin nëpërmjet skemave të garancisë, unë nuk e di se çfarë temë politike mund të jetë kjo! Kjo është vetëm temë ekonomike. Prandaj, kërkesa është të veshim këtë xhakët logjike dhe ta aprovojmë këtë akt normativ tani, por edhe çdo akt normativ që vjen si ndihmë e këtij instrumenti shumë të nevojshëm për biznesin e të gjitha madhësive dhe të gjithë sektorëve. Meqenëse kam pak kohë, dua të jap një përgjigje për kolegun Mediu, i cili pak më parë foli për çështjen e shumë diskutuar, ajo për të cilën jo gjithmonë flitet ashtu sikurse është, që lidhet me monitorimin e shtuar që Shqipëria ka vijuar të ketë brenda strukturave të MONEYVAL-it.

Dy fjalë në lidhje me këtë gjë, për të qenë të qartë dhe të saktë. Në plenaren 63 të MONEYVAL-it, që u mbajt më 19 maj të këtij viti, Shqipëria doli nga ndjekja e përforcuar, e cila ishte vendosur pak muaj më parë. Gjithashtu, nga 40 rekomandime, 36 rekomandime janë plotësuar totalisht. Janë 4 rekomandime, të cilat janë ende pjesërisht të plotësuar. Janë 3 rekomandime për të cilat është njohur një progres i konsiderueshëm dhe kjo në një periudhë gati 2-vjeçare, ku janë përfshirë të gjitha strukturat në atë që është plani i aksionit, së bashku me strukturën teknike FATF, ku është punuar përtej situatës së pandemisë dhe të krizës, me akte juridike nga të gjitha institucionet e përfshira.

Pra, kemi siguruar, që të paktën për këto 3 rekomandime, të kemi një përmirësim shumë të dukshëm. Këto nuk i thotë asnjëri dhe megjithatë duhet ta vlerësojmë punën e bërë gjatë këtyre dy vjetëve, për t'i aprovuar, këtu, në këtë Parlament të nderuar. Gjithashtu, duhet ta marrim edhe si meritë të Parlamentit të gjithë paketën e ligjeve MONEYVAL, përgatitjen e bazës për regjistrin e llogarive bankare dhe pronarëve përfitues, njohjen nga strukturat teknike për të gjithë punën që është bërë për përmirësimin e procedurave të licencimit si nga Banka e Shqipërisë, si nga AMF-ja, si nga Ministria e Drejtësisë për sa u përket noterëve dhe agentëve të pasurive të paluajtshme, ashtu edhe nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike. Këto janë progres.

Nuk është bërë pushim këto 2 vjet, por është punuar së bashku me të gjitha strukturat, për të realizuar objektivin për të dalë nga Lista Gri. Por nuk dilet nga Lista Gri brenda një dite. Përpara

4 vjetësh ka qenë Serbia në Listën Gri, ka punuar 2 vjet, ashtu siç po punojmë, ne për të përmirësuar treguesit. Tani, të mos njohësh as përmirësimet e këtyre dy vjetëve, do të thotë që optika politike prevalon përsëri kundrejt logjikës, informimit transparent për qytetarët dhe për të gjithë ne. Prandaj, është e rëndësishme të vendosim përpara të gjithë qytetarëve elementet e nevojshme për informacion.

Për t'iu kthyer përsëri çështjes për të cilën sot kemi aktin normativ, dua t'u them edhe një herë të gjithë kolegëve të mi parlamentarë, të bëjmë politikë, të diskutojmë edhe për masat nëse janë të mjaftueshme apo të pamjaftueshme, por kur vjen çështja për të mbështetur biznesin me akses në financë, për të rritur nevojën për likuiditet, uljen e burokracive, uljen e normës së interesit, uljen e kërkesës për më shumë kolateral, vetëm një gjë duhet të ndodhë: aprovimi i plotë i akteve normative për garanci shtetërore.

Mbi të gjitha duhet një falënderim për përpjekjen që ka bërë qeveria përgjatë viteve, jo vetëm në kohë krize, për të instrumentalizuar këtë produkt financiar në mbështetje të biznesit sot dhe gjithmonë. Faleminderit!